

VENDIM
Nr. 17, datë 23.2.2026

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fiona Papajorgji	kryetare;
Marsida Xhaferllari	anëtare;
Sandër Beci	anëtar;
Ilir Toska	anëtar;
Genti Ibrahim	anëtar;
Marjana Semini	anëtare;
Asim Vokshi	anëtar;
Sonila Bejtja	anëtare,

me sekretare Farisja Idrizaj, në datën 17.2.2026, mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 7 (H) 2025 të Regjistrisë Themeltar, që u përket:

KËRKUESE: Hysnie Mahmuti, Melaize Ruli, Lale Meçi, përfaqësuar nga avokati Taulant Asllanaj, me prokurë.

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Agjencia e Trajtimit të Pronave, në mungesë.

Avokatura e Shtetit, përfaqësuar nga avokatja e shtetit Irma Qosja.

OBJEKTI: Rihapja e procesit gjyqësor përpara Gjykatës Kushtetuese dhe shfuqizimi i vendimit nr. 199, datë 2.11.2016, të Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese.

Shfuqizimi i vendimeve nr. 10029, datë 9.12.2011, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; nr. 00-2016-528, datë 18.2.2016, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 27, 71/a dhe 71/c, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Sonila Bejtja, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkueseve, Hysnie Mahmuti, Melaize Ruli dhe Lale Meçi (*kërkueset*), të cilat kanë kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjektit të interesuar, Avokaturës së Shtetit, i cili ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, konstatoi mungesën e parashtrimeve të subjektit të interesuar, Agjencisë së Trajtimit të Pronave (*ATP*), si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkueset janë trashëgimtare ligjore të babait të tyre të ndjerë H. G., i cili nga ana e tij ka qenë trashëgimtar ligjor i të ndjerit M. G. Me pretendimin se ky i fundit ka qenë pronar i dy kullotave në Malin e Gjerë, Gjirrokastër, babai i kërkueseve i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirrokastër, e cila, me vendimin nr. 1043, datë 17.12.2003, ka vendosur vërtetimin e faktit juridik të pronësisë së trashëgimlënësit të tij M. G., përpara vitit 1945, për një sipërfaqe toke

kullotë prej 357 hektarësh. Ky vendim ka marrë formë të prerë më 5.1.2004. Ndërkohë, për këtë sipërfaqe toke, në vitin 2000 Radio Televizionit Shqiptar i është dhënë leje për ndërtimin e një pike transmetimi radiotelevizive.

2. Në vijim, babai i kërkueseve ka paraqitur kërkesë për njohjen e së drejtës së pronësisë dhe për kompensimin fizik ose financiar për pronën në fjalë. Me vendimin nr. 66, datë 20.2.2006, Komisioni Vendor për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave (KVKKP), Gjirokastrë, bazuar në ligjin nr. 9235, datë 29.7.2004, “Për kthimin dhe kompensimin e pronës” (*Ligji për Kthimin dhe Kompensimin e Pronës*), i ka njohur subjektit të shpronësuar M. G. pronësinë për pasurinë e llojit “kullotë”, të ndodhur në Malin e Gjerë, Gjirokastrë, me sipërfaqe të përgjithshme 335 hektarë, duke ua kthyer atë fizikisht trashëgimtarëve të tij. Ky komision ka konstatuar se në kullotën në fjalë ndodheshin katër antena dhe se pika e transmetimit radioteleviziv, për të cilën ishte lëshuar leja e ndërtimit për Radio Televizionin Shqiptar, nuk ishte ndërtuar ende. Ky vendim, duke u konsideruar titull pronësie, është regjistruar më pas në regjistrin e pasurive të paluajtshme dhe trashëgimtarët e M. G. janë pajisur me dokumentacionin përkatës të pronësisë.

3. Në vitin 2007 ligji për kthimin dhe kompensimin e pronës u ndryshua me ligjin nr. 9684, datë 6.2.2007, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9235, datë 29.7.2004, ‘Për kthimin dhe kompensimin e pronës’, të ndryshuar”, i cili parashikoi mundësinë e paraqitjes nga Avokatura e Shtetit të ankesave në zyrën qendrore të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (AKKP), si organi që ka zëvendësuar strukturën e mëparshme për kthimin dhe kompensimin e pronave, edhe ndaj vendimeve të ish-komisioneve të pronave, pa përcaktuar një afat kohor. Po kështu, ky ligj parashikonte se drejtori i AKKP-së mund të shqyrtonte dhe të anulonte, me nismën e tij, edhe vendimet e ish-komisioneve të pronave, por pa përcaktuar një afat kohor. Ligji për kthimin dhe kompensimin e pronës u ndryshua sërish me ligjin nr. 10207, datë 23.12.2009, “Për disa ndryshime në ligjin nr. 9235, datë 29.7.2004, ‘Për kthimin dhe kompensimin e pronës’, i ndryshuar” (*ligji nr. 10207/2009*), duke parashikuar se kundër vendimit të AKKP-së subjekti i shpronësuar ose Avokati i Shtetit mund të bënte ankim brenda 30 ditëve nga njoftimi i vendimit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, sipas rregullave të Kodit të Procedurës Civile (KPC).

4. Në datën 6.4.2009, Radio Televizioni Shqiptar, i cili ishte paditur në gjykatë nga babai i kërkueseve për heqjen e antenave nga toka e tij, i ka kërkuar Avokaturës së Shtetit të niste shqyrtimin e vendimit të KVKKP-së, Gjirokastrë, me pretendimin se ai përmbante elemente pavlefshmërie. Mbi këtë bazë, në datën 7.5.2009, Avokatura e Shtetit ka paraqitur ankim përpara drejtorit të përgjithshëm të AKKP-së, i cili, po ashtu, ka vendosur të ushtrojë edhe të drejtën e tij për shqyrtimin e atij vendimi, me nismën e vet. Në përfundim, me vendimin nr. 186, datë 25.5.2010 (*vendimi nr. 186/2010*), ai ka konstatuar si absolutisht të pavlefshëm vendimin e KVKKP-së, Gjirokastrë.

5. Një ditë më pas, në datën 26.5.2010, Gjykata Kushtetuese (*Gjykata*), me vendimin nr. 27, datë 26.5.2010 (*vendimi nr. 27/2010*), ka vendosur shfuqizimin e shkronjave “c”, “ç”, “d” e “dh”, të pikës 1, të nenit 15 dhe nenit 16 të ligjit për kthimin dhe kompensimin e pronës, të ndryshuar me ligjin nr. 10207/2009. Gjykata ka arsyetuar se pushteti i AKKP-së për të shqyrtuar vendimet e ish-komisioneve të pronave, edhe me nismën e saj, ishte antikushtetues. Sipas Gjykatës, një kërkesë e paraqitur pranë komisionit të pronës ishte ekuivalente me një padi të paraqitur në gjykatë dhe, për këtë arsye, vendimet e komisioneve të pronave krijonin të njëjtat pritshmëri, si dhe vendimet gjyqësore, pasi ato nuk ishin vetëm akte administrative, por vendime me natyrë *quasi gjyqësore*. Nisur nga kjo, sipas saj, vetëm një autoritet gjyqësor dhe jo një autoritet administrativ, si AKKP-ja, mund të shqyrtonte një masë për rishikimin e një vendimi të komisionit të pronave. Gjykata ka theksuar se, në mungesë të një ankese, vendimet e komisioneve të pronave bëheshin të formës së prerë, detyruese për palët në procedime dhe të zbatueshme sipas ligjit, njësoj si vendimet gjyqësore.

6. Në datën 22.7.2010, është miratuar ligji nr. 10308, datë 22.7.2010, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9235, datë 29.7.2004, ‘Për kthimin dhe kompensimin e pronës’, i ndryshuar” (*ligji nr. 10308/2010*), i cili ndryshonte sërish ligjin për kthimin dhe kompensimin e pronës, duke i rikthyer të njëjtat kompetenca drejtorit të AKKP-së. Gjykata, me vendimin nr. 43, datë 6.10.2011 (*vendimi nr. 43/2011*), ka vendosur shfuqizimin e neneve 2, 3 dhe 5, të ligjit nr. 10308/2010, duke arsyetuar, me të njëjtat argumente, se ato cenonin parimin e sigurisë juridike të lidhur me të drejtën e pronës.

7. Në vijim, babai i kërkueseve i është drejtuar gjykatës me padi, duke kërkuar anulimin e vendimit nr. 186/2010 të drejtorit të përgjithshëm të AKKP-së, që kishte konstatuar si absolutisht të pavlefshëm vendimin e KVKKP-së, Gjirokastër, që i kishte njohur subjektit të shpronësuar pronën dhe ua kishte kthyer atë fizikisht trashëgimtarëve të tij. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 10029, datë 9.12.2011, ka vendosur rrëzimin e padisë, me arsyetimin se vendimi i KVKKP-së, Gjirokastër nuk ishte anuluar nga drejtori i përgjithshëm i AKKP-së, sikurse pretendonte paditësi, por ishte ndryshuar pas një ankese të Avokaturës së Shtetit. Gjithashtu, sipas saj, paditësi nuk kishte paraqitur mjaftueshëm prova për të provuar pronësinë e babait të tij për tokën. Pas ankimit, Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 2457, datë 18.10.2012, ka vendosur ndryshimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë, pranimin e padisë dhe anulimin e vendimit nr. 186/2010 të drejtorit të përgjithshëm të AKKP-së. Sipas saj, pushteti i AKKP-së për të shqyrtuar dhe anuluar vendimet e formës së prerë të komisioneve të pronave ishte shpallur jokushtetues nga Gjykata. Po sipas saj, pronësia e kërkuesit ndaj tokës është mbështetur në të dhëna të mjaftueshme dhe në ligjin për kthimin dhe kompensimin e pronës. Mbi rekursin e AKKP-së, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2016-528 (54), datë 18.2.2016, ka vendosur prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë. Ky kolegji ka arsyetuar se paditësi (babai i kërkueseve) nuk ka provuar se babai i tij e kishte zotëruar tokën. Po sipas tij, nuk ekzistonte asnjë problematikë për sigurinë juridike, pasi vendimi i KVKKP-së, Gjirokastër nuk ishte bërë asnjëherë i formës së prerë, për shkak se Avokatura e Shtetit kishte paraqitur ankesë brenda afatit ligjor 30-ditor të parashikuar nga ligji nr. 10207/2009.

8. Më pas, babai i kërkueseve i është drejtuar Gjykatës me kërkesë për kundërshtimin e vendimeve të mësipërme të gjykatës së shkallës së parë dhe të Gjykatës së Lartë, duke pretenduar cenimin e procesit të rregullt ligjor në aspektet e së drejtës për t’u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj, parimit të barazisë së armëve, atij të sigurisë juridike dhe standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor. Kolegji i Gjykatës, me vendimin nr. 199, datë 2.11.2016, ka vendosur moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare, duke i vlerësuar pretendimet e ngritura si haptazi të pabazuara.

9. Në datën 2.5.2017, babai i kërkueseve i është drejtuar Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*GJEDNJ*) (*Aplikimi nr. 33369/17 Gaba k. Shqipërisë*), duke pretenduar shkelje të parimit të sigurisë juridike sipas nenit 6, paragrafit 1, të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*), për shkak të prishjes së vendimit të formës së prerë të KVKKP-së, Gjirokastër, me të cilin ishte njohur e drejta e pronës dhe kjo e fundit ishte kthyer fizikisht. Gjatë shqyrtimit të çështjes, në datën 18.11.2018, babai i kërkueseve ka ndërruar jetë dhe ato, si trashëgimtare të tij, kanë shprehur dëshirën të vijonin procedimet në emër të tij dhe, mbi këtë bazë, GJEDNJ-ja ka vazhduar shqyrtimin e çështjes. Në përfundim, me vendimin e datës 17.12.2024, GJEDNJ-ja e ka konstatuar shkeljen e parimit të sigurisë juridike sipas nenit 6, paragrafit 1, të KEDNJ-së nga ana e autoriteteve vendase, të cilat kishin anuluar vendimin e vitit 2006 të komisionit për rikthimin e pronës në favor të kërkuesit.

10. Në vendimin e saj, GJEDNJ-ja ka vlerësuar se çështja kryesore juridike përpara saj lidhej me atë nëse vendimi i KVKKP-së, Gjirokastër ishte i formës së prerë dhe, nëse po, nëse shqyrtimi përjashtimor dhe rrëzimi i tij ishin bërë të detyrueshëm nga rrethanat të karakterit thelbësor dhe

detyruet, ose nëse ai shqyrtim kishte sjellë një rigjykim të çështjes. Në këtë kuadër, ajo ka hedhur poshtë prapësimin e qeverisë shqiptare se ky vendim nuk ishte bërë i formës së prerë dhe se ishte ndryshuar me anë të një ankese të zakonshme. Sipas GJEDNJ-së, në përputhje me jurisprudencën e Gjykatës, vendimi në fjalë ishte bërë i formës së prerë dhe kundërshtimi i tij përbënte një mjet të jashtëzakonshëm (*shih paragrafin 85 të vendimit të GJEDNJ-së*). Më tej, ajo ka theksuar se fuqia e gjykatave më të larta për të prishur ose ndryshuar vendime gjyqësore detyruese dhe të zbatueshme synon korrigjimin e gabimeve dhe dështimeve gjyqësore të drejtësisë, por jo realizimin e një shqyrtimi të ri, ndaj ky pushtet duhet të ushtrohet për të arritur një balancë të drejtë midis interesave të individit dhe nevojës për efektivitetin e sistemit të drejtësisë. Po kështu, ajo ka theksuar se një defekt themelor në procedim, si për shembull një gabim juridiksional, shkelje të rënda të procedurës gjyqësore, abuzim me pushtetin, gabime të dukshme në zbatimin e ligjit thelbësor ose çdo arsye tjetër e rëndësishme që buron nga interesat e drejtësisë, në parim, mund të justifikojë distancimin nga parimi i sigurisë juridike. Në analizë të rastit konkret, GJEDNJ-ja ka vlerësuar se në periudhën përkatëse pushteti i Avokatit të Shtetit për të kundërshtuar vendimet e ish-komisioneve të pronës nuk ishte i kufizuar në kohë. Për këtë arsye, një kuadër kohor i pakufizuar për marrjen e një mase të tillë nuk mund të konsiderohej i pranueshëm nga këndvështrimi i afateve kohore, qartësisë procedurale dhe parashikueshmërisë së procedurave, të cilat përbëjnë elemente me rëndësi madhore sipas nenit 6, paragrafi 1, të KEDNJ-së. Më tej, ajo ka vërejtur se Avokati i Shtetit mund të kërkonte shqyrtimin e një vendimi të formës së prerë të një ish-komisioni të pronës për çdo arsye juridike të natyrës së përgjithshme, dhe jo për rrethana thelbësore dhe detyruese (*shih paragrafët 86–89 të vendimit të GJEDNJ-së*).

11. Në rastin konkret, sipas GJEDNJ-së, Gjykata e Tiranës dhe Gjykata e Lartë arritën në përfundimin se kërkuesi nuk kishte mundur të provonte se babai i tij e kishte zotëruar tokën, pa konsiderata të mëtejshme për ndonjë defekt thelbësor në procedurat e mëparshme ose për mungesën e konsideratës ndaj interesit publik në procesin e rikthimit të pronës. Po kështu, ato nuk theksuan emergjencën e ndonjë prove dhe as hodhën dyshime mbi vërtetësinë e provave që ndodheshin tashmë në dosjen e çështjes. Sipas GJEDNJ-së, në thelb, ato gjykata rishqyrtuan faktet ekzistuese dhe të njohura, të shqyrtuara më parë nga KVKKP-ja, Gjirokastër, dhe përdorën diskrecionin e tyre për të arritur një përfundim të kundërt me atë të vendimit të formës së prerë. Për rrjedhojë, nuk mund të arrihej në përfundimin se ekzistonin rrethana thelbësore dhe detyruese që justifikonin anulimin e vendimit të KVKKP-së, Gjirokastër të vitit 2006 (*shih paragrafët 90–92 të vendimit të GJEDNJ-së*). Për këto arsye, GJEDNJ-ja ka arritur në përfundimin se është shkelur neni 6, paragrafi 1, i KEDNJ-së për sa i përket anulimit të një vendimi të formës së prerë, pa rrethana thelbësore dhe detyruese që justifikonin këtë masë (*shih paragrafin 93 të vendimit të GJEDNJ-së*).

12. Në lidhje me korrigjimin e shkeljes së konstatuar të nenit 6, paragrafi 1, të KEDNJ-së, GJEDNJ-ja, pasi ka vërejtur se ligji vendas parashikon mundësinë e rihapjes së procedurave gjyqësore për çështjet ku ajo ka konstatuar shkelje të KEDNJ-së, ka vlerësuar se, në rrethanat e rastit konkret, forma më e përshtatshme e korrigjimit për kërkuetin do të ishte rihapja e procedurave, nëse ai do ta kërkonte një gjë të tillë, si dhe rishqyrtimi i çështjes në përputhje me të gjitha kërkesat e nenit 6, paragrafi 1, të KEDNJ-së (*shih paragrafin 101 të vendimit të GJEDNJ-së*).

13. Vendimi i GJEDNJ-së është bërë përfundimtar në datën 17.3.2025 dhe është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 70, datë 22.4.2025.

14. Ndërkohë, në datën 17.4.2025, kërkuet i janë drejtuar Gjykatës me kërkesë për rihapjen e procesit gjyqësor dhe shfuqizimin e vendimit të Kolegjit të Gjykatës dhe rishqyrtimin e kërkesës së tyre për kundërshtimin e vendimeve të gjykatave të zakonshme. Kërkesa, pasi është plotësuar sipas kërkesave të Ligjit Organik të Gjykatës, është regjistruar në datën 29.4.2025. Në datën 8.7.2025, Kolegji i Gjykatës ka vendosur kalimin e kërkesës për shqyrtim paraprak në Mbledhjen

e Gjyqtarëve, e cila në datën 15.7.2025, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

15. **Kërkueset**, në mënyrë të përmbledhur, kanë pretenduar:

15.1 Vendimet e kundërshtuara duhet të shfuqizohen, pasi GJEDNJ-ja ka konstatuar shkelje të parimit të sigurisë juridike sipas nenit 6, paragrafi 1, të KEDNJ-së, për shkak të anulimit të vendimit të formës së prerë të vitit 2006 të KVKKP-së, Gjirokastër, me të cilin babait të tyre i ishte njohur e drejta e pronës dhe i ishte kthyer ajo fizikisht. GJEDNJ-ja ka trajtuar aspektet kryesore juridike të çështjes dhe ka vlerësuar se forma më e përshtatshme për korrigjimin e shkeljes është rihapja e procedurave të brendshme dhe rishqyrtimi i çështjes në përputhje me kërkesat e nenit 6, paragrafi 1, të KEDNJ-së.

15.2 Vendimet e kundërshtuara të gjykatave të zakonshme kanë cenuar të *drejtën për proces të rregullt ligjor*, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së, në aspektet e mëposhtme:

15.2.1 *Së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj*, pasi Gjykata e Lartë ka tejkaluar kompetencat dhe kufijtë e shqyrtimit të çështjes, duke vepruar si gjykatë fakti dhe jo si gjykatë ligji. Ajo ka rivlerësuar provat e administruara nga gjykatat më të ulëta, ka ndryshuar faktet dhe rrethanat e çështjes, ka arritur në përfundime të ndryshme nga ato të gjykatës së apelit, si dhe ka anashkaluar qëllimisht vlerën e disa provave të rëndësishme për zgjidhjen e çështjes. Për më tepër, shkaqet për të cilat është pranuar rekursi janë të ndryshme nga ato të pretenduara nga vetë rekursuesi. Vendimi i Gjykatës së Lartë është kontradiktor, pasi edhe pse baza ligjore mbi të cilën është mbështetur vendimi i drejtorit të përgjithshëm të AKKP-së ishte shfuqizuar, ajo ka vlerësuar se pasojat e atij procesi mbeteshin të vlefshme.

15.2.2 *Parimit të barazisë së armëve*, pasi gjykata e shkallës së parë dhe Gjykata e Lartë nuk kanë bërë pjesë të analizës së tyre provat shkresore të depozituara nga kërkuesi në atë proces, duke e vendosur atë në pozitë të pafavorshme përballë palës tjetër.

15.2.3 *Parimit të sigurisë juridike në drejtim të “res judicata”*, pasi Gjykata e Lartë nuk e ka trajtuar çështjen në përputhje me objektin e padisë, duke u shprehur për vendimmarrjen e drejtorit të përgjithshëm të AKKP-së, por ka rihapur çështjen e vërtetimit të pronësisë së kërkuesit dhe të trashëgimlënësit të tij. Në këtë mënyrë, ajo është shprehur për një pretendim që ishte vërtetuar me vendimin e formës së prerë nr. 1043, datë 17.12.2003, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër.

15.2.4 *Parimit të sigurisë juridike në drejtim të pritshmërive të ligjshme*, siç ka konstatuar edhe GJEDNJ-ja.

15.2.5 *Standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor*, pasi vendimi i Gjykatës së Lartë bie ndesh me vendimin nr. 43/2011 të Gjykatës, me të cilin është shfuqizuar e drejta e drejtorit të përgjithshëm të AKKP-së për shfuqizimin e vendimeve të komisionit të pronave që kishin marrë formë të prerë. Qëndrimi, arsyetimi dhe vendimmarrja e Gjykatës së Lartë janë të paqarta, konfuze dhe kontradiktore, duke ardhur në kundërshtim edhe me vetë praktikën e saj, përfshirë vendimin unifikues nr. 2, datë 21.1.2011, sipas të cilit kundërshtimi i vendimeve të komisioneve për kthimin e pronës bën pjesë në juridiksionin gjyqësor dhe jo në atë administrativ.

16. **Subjekti i interesuar, Avokatura e Shtetit**, në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar se pretendimi për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor është i pabazuar, për sa vijon:

16.1 Pretendimi për cenimin e së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj është i pabazuar, pasi Gjykata e Lartë nuk rezulton të ketë tejkaluar kompetencat dhe kufijtë e shqyrtimit të çështjes përmes rivlerësimit të provave të marra gjatë gjykimit në gjykatat e faktit. Ajo është fokusuar vetëm në drejtim të ligjshmërisë së vendimit të kundërshtuar, pra në mënyrën e zbatimit

të ligjit nga gjykatat më të ulëta. Po kështu, nuk rezulton që Gjkata e Lartë të ketë ndryshuar faktet dhe rrethanat, të cilat janë parashtruar në mënyrë të saktë në vendimin e saj. Vendimi i gjykatës së apelit ka qenë në kundërshtim me dispozitat ligjore të kohës, duke cenuar jo vetëm parimin e sigurisë juridike, por edhe interesin publik, pasi ka disponuar për kthimin e pronës që, në kuptim të ligjit, konsiderohej e zënë. Ky vendim është vlerësuar me të drejtë nga Gjkata e Lartë se është rrjedhojë e mosrespektimit të ligjit material.

16.2 Pretendimi për cenimin e *parimit të barazisë së armëve* është i pabazuar, pasi Gjkata e Lartë e ka shqyrtuar çështjen në seancë gjyqësore publike, duke garantuar të drejtën e palëve për t'u dëgjuar për themelin e mosmarrëveshjes. Nuk rezulton që ajo gjykatë ta ketë vënë babanë e kërkueseve në pozitë më pak të favorshme se pala tjetër, ndërkohë që ai ka ushtruar të drejtat e tij procedurale duke paraqitur kundërrkurs, si dhe parashtrime me shkrim në seancë gjyqësore.

16.3 Edhe pretendimi për cenimin e *parimit të sigurisë juridike* në drejtim të *gjësë së gjykuar* është i gabuar dhe në kundërshtim me përmbajtjen e këtij parimi. Fakti që Gjkata e Lartë është shprehur për një çështje të zgjidhur më parë me vendim të formës së prerë nuk do të thotë se kemi të bëjmë me cenim të gjësë së gjykuar.

16.4 I pabazuar është edhe pretendimi për cenimin e *sigurisë juridike* në drejtim të *të drejtave të fituara*, pasi AKKP-ja ka vepruar mbi bazën e dispozitave ligjore në fuqi në kohën e marrjes së vendimit dhe jo mbi bazën e një dispozite të shfuqizuar. Për rrjedhojë, vendimmarrja e saj nuk mund të konsiderohet antikushtetuese dhe as në cenim të parimit të sigurisë juridike. Shfuqizimi i një dispozite ligjore për papajtueshmëri me Kushtetutën nuk cenon vlefshmërinë e akteve administrative ose gjyqësore të dhëna mbi bazën e saj përpara shfuqizimit, përveç rasteve kur ligjvënësi ka parashikuar shprehimisht efektin prapaveprues, gjë që në rastin konkret mungon. Po kështu, KVKKP-ja, Gjyrostastër ka pasur detyrimin të respektojë parashikimet ligjore dhe të mos dispononte me kthimin e sipërfaqes së tokës mbi të cilën ishin ngritur antenat transmetuese lokale dhe kombëtare të televizionit.

16.5 Vendimi i Gjykatës së Lartë dhe ai i gjykatës së shkallës së parë përmbushin *standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor*. Ky standard nuk nënkupton që vendimi duhet të përputhet me pritshmëritë subjektive të palëve, por që gjykata të paraqesë një arsyetim të mjaftueshëm për të kuptuar bazën ligjore të vendimmarrjes së saj. Gjykatat kanë analizuar rrethanat konkrete dhe kanë dhënë një zgjidhje në përputhje me kuadrin ligjor të zbatueshëm. Pretendimi se ky vendim është në kundërshtim me vendimet e Gjykatës së Lartë dhe të Gjykatës nuk qëndron, pasi vendimi nr. 27/2010 i Gjykatës, me të cilin u shfuqizuan disa dispozita të ligjit për kthimin dhe kompensimin e pronës, prodhon pasoja për të ardhmen dhe nuk ka efekt mbi aktet individuale të mëparshme dhe as imponon një interpretim të vetëm në çdo rast gjyqësor që lidhet me vendime të ish-komisioneve të pronave.

17. **Subjekti i interesuar, ATP-ja**, nuk ka paraqitur parashtrime me shkrim, megjithëse është njoftuar rregullisht.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

18. Gjkata vëren se referuar nenit 71/c, pikat 3 dhe 4, të Ligjit Organik të Gjykatës, nëse ajo ka vendosur më parë për një çështje, e cila është gjykuar nga një gjykatë ndërkombëtare dhe kjo e fundit ka konstatuar se janë cenuar të drejtat dhe liritë themelore të individit, si rrjedhojë e vendimit të Gjykatës, subjekti i cenuar, në favor të të cilit ka vendosur gjykata ndërkombëtare, ka të drejtë të paraqesë kërkesë për rihapjen e procesit gjyqësor, e cila paraqitet brenda 4 muajve nga hyrja në fuqi e vendimit të gjykatës ndërkombëtare. Kërkesa duhet të përmbajë një përmbledhje të vendimit të gjykatës ndërkombëtare me çështjet kryesore që ka konstatuar ajo gjykatë, kërkimet konkrete dhe kërkuesi duhet të kërkojë shprehimisht rihapjen e procesit, si dhe shfuqizimin e aktit.

19. Gjykata thekson se çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues, duke mos përjashtuar edhe rastin e rihapjes së procesit sipas nenit 71/c të Ligjit Organik të Gjykatës. Kriteret për pranueshmërinë e kërkesës për rihapje të procesit në këtë Gjykatë, sikurse të ankimit kushtetues individual, janë të natyrës kumulative, pra ato duhet të plotësohen njëkohësisht.

20. Duke verifikuar kriteret e legjitimitetit në rastin konkret, Gjykata konstaton se babai i kërkueseve i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual, duke pretenduar se vendimet e gjykatës së shkallës së parë dhe të Gjykatës së Lartë, me të cilat ishte rrëzuar padia e tij, cenonin të drejtën për proces të rregullt ligjor në aspektet e së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj, parimit të barazisë së armëve, parimit të sigurisë juridike dhe standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor, të garantuara nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së. Kolegji i Gjykatës ka vendosur moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare, me arsyetimin se pretendimet ishin haptazi të pabazuara. Më pas, kërkuesi në atë proces i është drejtuar GJEDNJ-së, e cila ka pranuar ankesën dhe ka konstatuar shkelje të nenit 6, paragrafi 1, të KEDNJ-së në drejtim të parimit të sigurisë juridike, për sa i përket anulimit të vendimit të formës së prerë të vitit 2006 të KVKKP-së, Gjirokastër, pa rrethana thelbësore dhe detyruese që justifikonin këtë masë (*shih paragrafët 10–11 të vendimit*). Pas vendimit të GJEDNJ-së kërkuaset, në cilësinë e trashëgimtareve të babait të tyre, i janë drejtuar Gjykatës me kërkesë për rihapjen e procesit, shfuqizimin e vendimit të Kolegjit të Gjykatës dhe rishqyrtimin e kërkesës së tyre për kundërshtimin e vendimeve të gjykatave të zakonshme, duke konsideruar se rihapja e procesit nga Gjykata përbën formën e përshtatshme për korrigjimin e shkeljes sipas vendimit të GJEDNJ-së.

21. Gjykata vëren se për vlerësimin e legjitimitetit të kërkueseve, në rastin konkret, merr rëndësi kushti i nenit 71/c, pika 3, të Ligjit Organik të Gjykatës, sipas të cilit rihapja e procesit kushtetues mund të kërkohej vetëm kur cenimi i konstatuar nga gjykata ndërkombëtare ka ardhur si rrjedhojë e vendimit të mëparshëm të kësaj Gjykate. Në këtë drejtim, Gjykata konstaton se, ndonëse GJEDNJ-ja ka gjetur shkelje të nenit 6, paragrafi 1, të KEDNJ-së në drejtim të parimit të sigurisë juridike, ajo nuk ia ka atribuar këtë cenim vendimmarrjes së Kolegjit të Gjykatës, por vendimmarrjes së gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, konkretisht Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Gjykatës së Lartë, të cilat kanë disponuar për anulimin e vendimit të formës së prerë të KVKKP-së, Gjirokastër pa rrethana thelbësore dhe detyruese që justifikonin këtë masë. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se kërkuaset nuk legjitimohen *ratione materiae*, në kuptim të nenit 71/c, pika 3, të Ligjit Organik të saj, për të kërkuar rihapjen e procesit kushtetues. Për pasojë, kërkesa për rihapjen e procesit kushtetues dhe shfuqizimin e vendimit të Kolegjit të Gjykatës duhet të rrëzohet.

22. Nga ana tjetër, ndonëse kërkesa e kërkueseve për rihapjen e procesit është paraqitur përpara saj, Gjykata vëren se, në thelb, ajo lidhet me rishikimin e vendimit të Gjykatës së Lartë, në kuptim të nenit 494, paragrafi 2, shkronja “ë”, të KPC-së. Në këto rrethana, me qëllim garantimin e një mbrojtjeje efektive të të drejtave themelore të kërkueseve dhe së drejtës së tyre për një mjet juridik efektiv për korrigjimin e shkeljes së konstatuar nga GJEDNJ-ja, Gjykata çmon se çështja objekt gjykimi duhet t'i dërgohet për shqyrtim gjykatës kompetente, pra Gjykatës së Lartë.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, bazuar në nenin 71/c, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, njëzëri,

VENDOSI:

1. Rrëzimin e kërkesës për rihapjen e procesit kushtetues.

2. Dërgimin e çështjes për shqyrtim në Gjykatën e Lartë.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 23.2.2026.

Shpallur më 2.4.2026.

Kryetare: Fiona Papajorgji

Anëtarë: Sandër Beci, Marsida Xhaferllari, Marjana Semini, Genti Ibrahim, Ilir Toska, Sonila Bejtja

Anëtarë pjesërisht kundër: Asim Vokshi

MENDIM PAKICE

1. Në shqyrtimin e çështjes që i përket kërkesës së kërkuueseve Hysnie Mahmuti etj., me objekt rihapjen e procesit gjyqësor përpara Gjykatës, shfuqizimin e vendimit nr. 199, datë 2.11.2016, të Kolegjit të Gjykatës, si dhe shfuqizimin e vendimeve nr. 10029, datë 9.12.2011, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; nr. 00-2016-528, datë 18.2.2016, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën, unë, gjyqtari Asim Vokshi, jam pjesërisht kundër vendimit të shumicës për dërgimin e çështjes për shqyrtim në Gjykatën e Lartë, për arsyt si më poshtë.

2. Siç pranon shumica, vendimi i GJEDNJ-së nuk i referohet vendimmarrjes së Gjykatës dhe nuk ka gjetur shkelje në vendimmarrjen e saj. Përkundrazi, shkelja e nenit 6 të KEDNJ-së, sipas GJEDNJ-së, u referohet gjykimeve të zhvilluara në gjykatat e zakonshme deri në Gjykatën e Lartë. Në lidhje me këtë, Gjykata nuk “thirret në lojë” për sa i përket rihapjes së procesit gjyqësor në atë gjykatë, ndaj pajtohem me argumentimin e shumicës se duhej rrëzuar kërkesa e kërkuueseve për rihapjen e procesit kushtetues.

3. Nga ana tjetër, nuk pajtohem me konkluzionin e arritur nga shumica se Gjykata duhet t’i dërgojë për kompetencë shqyrtimi këtë çështje Gjykatës së Lartë. Vetë Gjykata ka një praktikë të konsoliduar gjyqësore ku afirmon se “nuk është shkallë e katërt e gjyqësorit të zakonshëm” dhe rrjedhimisht nuk duhet të sillet si e tillë. Juridiksioni kushtetues është i shkëputur nga juridiksioni i gjykatave të zakonshme dhe Gjykata nuk është pjesë e sistemit gjyqësor. Fakti se pasi shterohen mjetet e ankimit në gjykatat e zakonshme dhe individët kanë të drejtën e ankimit kushtetues individual, nuk e bën Gjykatën shkallë të katërt të gjyqësorit dhe as hallkë të zakonshme ankimi.

4. Kërkesa për rishikimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë sipas neneve 494 e vijues të KPC-së gjen zbatim për gjykatat e zakonshme sipas kompetencës që parashikon ligji. Përbën rast rishikimi kur GJEDNJ-ja gjen shkelje të KEDNJ-së dhe të protokolleve të saj, të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë. Sipas nenit 497, pika 1 të KPC-së kërkesa për rishikim paraqitet përpara gjykatës së juridiksionit të zakonshëm që ka dhënë vendimin e themelit (pavarësisht shkallës së saj) dhe paraqitja, sipas nenit 496 të KPC-së, duhet të bëhet brenda 30 ditëve nga dita që pala provon se ka marrë dënim për shkakun e rishikimit. Sipas nenit 444 të KPC-së, afati 30-ditor është afat i prerë dhe humbja e tij mund të passjellë vetëm paraqitjen e një kërkesë për rivendosjen në afat, kur janë shkaqet e parashikuara nga neni 151 i KPC-së. Sipas nenit 36 të KPC-së, juridiksioni gjyqësor përcaktohet në momentin e paraqitjes së padisë (kërkesës) në gjykatë dhe asnjë institucion tjetër nuk ka të drejtë të pranojë për shqyrtim çështje që janë duke u gjykuar nga gjykata. KPC-ja nuk njeh mundësinë që një akt që duhet të paraqitet në gjykatë mund të depozitohet në afat në një institucion jogjyqësor dhe ky fakt të ndikojë në quajtjen e aktit si të paraqitur në afat për efekt të llogaritjes së afateve procedurale të gjykatës. Gjykatat e zakonshme mund të rivendosin në afat aktin procedural nëse binden se janë rrethanat e parashikuara nga neni 151 i KPC-së, por kjo shihet rast pas rasti.

5. Ligji Organik i Gjykatës nuk ka rregulluar situatën se ç'fat ka një akt procedural i paraqitur gabimisht në Gjykatë, për efekt të konsiderimit të tij ose jo, si i paraqitur në afat pranë një juridiksioni tjetër (përfshirë atë të gjykatave të zakonshme), të cilit në fakt do të duhej t'i ishte drejtuar akti procedural. Thënë ndryshe, ligji i mësipërm nuk ka rregullim për situatën kur pala në vend t'i drejtohet me kërkesë për rishikim gjykatave të zakonshme, sipas orientimit të vendimmarrjes së GJEDNJ-së, i drejtohet gabimisht Gjykatës, pasi ka bindjen se është kjo Gjykatë që duhet të rihapë procedurat, ndonëse GJEDNJ-ja nuk ka gjetur asnjë shkelje në vendimmarrjen e Gjykatës. Iniciativa e gabuar e palës, e cila përfaqësohet edhe me avokat, nuk duhet ta shtyjë Gjykatën që ta dërgojë çështjen që iu paraqit asaj për shqyrtim tek asnjë institucion tjetër, ku vetë pala do të duhej të kishte paraqitur një kërkesë tjetër, e cila ndonëse e ngjashme, i drejtohet një juridiksioni krejt të ndryshëm. Neni 27, pika 3 i Ligjit Organik të Gjykatës njeh vetëm rastin kur kërkesa që i duhej drejtuar Gjykatës i është drejtuar gabimisht një institucioni tjetër dhe rrjedhimisht për shkak të kësaj ngatërrese të palës, ajo depozitohet jashtë afatit në Gjykatë. Sipas kësaj dispozite ligjore, Gjykata ka mundësi ta konsiderojë kërkesën të paraqitur në afat, në rast se provohet se kjo ngatërresë ka ndodhur në mirëbesim. Pra, edhe në këtë rast, Gjykata nuk e merr automatikisht të mirëqenë se kërkesa e depozituar në një institucion tjetër është dorëzuar atje gabimisht në mirëbesim, por kërkon prova për ngatërresën në fjalë. Në këtë rast, ngatërresa nuk duhet të lidhet me bindjen e kërkuueseve se institucioni tjetër ishte organi kompetent për zgjidhjen e saj, por vetëm me rastin kur kërkesa i drejtohej Gjykatës, por për shkak të një gabimi njerëzor ose rasti fitor ka ndodhur që është depozituar në afat pranë një institucioni tjetër, por jashtë afati kur ajo sillet në Gjykatë.

6. I njëjti standard si më sipër duhet të vlejë edhe për rastet kur pala gabimisht paraqet në Gjykatë një kërkesë që qartazi u drejtohet gjykatave të zakonshme. Kërkesa mund të përcillet administrativisht te gjykatat e zakonshme, të cilat, në çdo rast, në zbatim të institutit të rivendosjes në afat, do të duhet të vlerësojnë nëse ngatërresa ka ardhur për shkak të ndonjë force madhore ose për shkaqe të tjera që nuk mund të ishin parashikuar prej tyre. Por vlerësoj se nuk përfshihet në këtë rast situata kur pala mendon se rivendosja e të drejtave të saj lidhet me rihapjen e procesit kushtetues dhe për këtë qëllim i drejtohet vullnetarisht me kërkesë Gjykatës. Analiza e Gjykatës dhe vendimmarrja e saj duhet të fokusohen ekskluzivisht te vlerësimi i shkaqeve, nëse ka ose jo rast për rihapjen e procesit kushtetues, dhe jo edhe nëse ka ose jo shkak për rishikimin e vendimeve të formës së prerë të gjykatave të zakonshme sipas neneve 494 e vijues të KPC-së. Këtë e bëjnë gjykatat e zakonshme kur vihen në lëvizje nga kërkuesi, sipas rregullave procedurale të parashikuara në KPC.

7. Në lidhje me sa më sipër, jam dakord se kërkesa për rihapjen e procesit kushtetues është e pabazuar në ligj, por nuk jam dakord që Gjykata duhet të dërgojë çështjen për shqyrtim në Gjykatën e Lartë, sepse kërkesa për rihapje të procesit kushtetues nuk është kërkesë për rishikim të vendimeve gjyqësore të formës së prerë të gjykatave të zakonshme dhe fakti se kërkueset, të përfaqësuara me avokat, kërkojnë rivendosjen e së drejtës së njohur nga GJEDNJ-ja, nuk përbën argument për miksimin e juridiksionit kushtetues me atë të gjykatave të zakonshme. Këto juridiksione janë të ndara dhe mendoj se Gjykata, në respekt të nenit 48, pika 1 të Ligjit Organik të Gjykatës, duhej ta shqyrtonte çështjen brenda objektit të kërkesës, e cila qartësisht lidhej me kërkimin për vendimmarrje nga Gjykata e jo nga Gjykata e Lartë. Zgjedhja me vullnet e juridiksionit kushtetues nga kërkueset, ndonëse e gabuar, përbën zgjedhje të tyre dhe fakti që kjo zgjedhje i është drejtuar juridiksionit të gabuar, nuk duhet të bëjë që Gjykata të ndërhyjë pa shkak në juridiksionin e gjykatave të zakonshme, nëpërmjet dërgimit të çështjes për shqyrtim pranë tyre. Kjo pasi çështja nuk i drejtohej Gjykatës së Lartë dhe gabimisht është paraqitur në këtë Gjykatë, por i është drejtuar kësaj Gjykate me bindjen e kërkuueseve se bazuar në nenin 71/c, pika 3 të Ligjit Organik të Gjykatës kishte vend për rihapje të procesit kushtetues. Këtu duhej të kishte mbaruar

analiza dhe vendimmarrja e Gjykatës, dhe jo ta dërgonte çështjen për shqyrtim në Gjykatën e Lartë. Pikërisht për pjesën e fundit nuk pajtohem me vendimin e shumicës.

Anëtar: Asim Vokshi